




**RREGULLAT E ARBITRAZHIT**  
QENDRA E ARBITRAZHIT E LUBJANËS  
NË ODËN E TREGTISË DHE INDUSTRIËSË SË SLLOVENISË

# RREGULLAT E ARBITRAZHIT TË LUBJANËS

[Shqip]

Zgjidhje e Kontesteve  
që nga viti 1928



© Qendra e Arbitrazhit e Lubjanës në Odën e Tregtisë dhe Industrisë së Sllovenisë (QAL), 2017

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Ky publikim është botuar nga Qendra e Arbitrazhit në Odën e Tregtisë dhe Industrisë së Sllovenisë.

Qendra e Arbitrazhit në Odën e Tregtisë dhe Industrisë së Sllovenisë dhe logo e saj janë marka tregtare të regjistruara të Odës së Tregtisë dhe Industrisë së Sllovenisë.




# RREGULLAT E ARBITRAZHIT

QENDRA E ARBITRAZHIT E LUBJANËS  
NË ODËN E TREGTISË DHE INDUSTRIË SË SLOVENISË

## RREGULLAT E ARBITRAZHIT TË LUBJANËS

[Shqip]



Zgjidhje e Kontesteve  
që nga viti 1928

**Qendra e Arbitrazhit e Lubjanës  
në Odën e Tregtisë dhe Industrisë së Sllovenisë**  
rruga Dimičeva 13, 1504 Lubjanë, Slloveni

**[www.sloarbitration.eu](http://www.sloarbitration.eu)**

**Sekretariati:**

t: +386 1 58 98 180

f: +386 1 58 98 400

[arbitraza.lj@gzs.si](mailto:arbitraza.lj@gzs.si)

# PËRMBAJTJA

## RREGULLAT E ARBITRAZHIT TË LUBJANËS 1

## DISPOZITAT HYRËSE 3

Neni 1

QAL

Neni 2

Fusha e zbatimit

Neni 3

Komunikimi me QAL

## FILLIMI I PROCEDURËS SË ARBITRAZHIT 4

Neni 4

Fillimi i procedurës

Neni 5

Kërkesa për Arbitrazh

Neni 6

Tarifa e Regjistrimit 5

Neni 7

Përgjigja në Kërkesën për Arbitrazh

Neni 8

Afatet kohore 6

Neni 9

Njoftimet dhe komunikimet

Neni 10

Refuzimi për të administruar rastin 7

Neni 11

Shkrirja

Neni 12

Bashkimi 8

## THEMELIMI I TRIBUNALIT TË ARBITRAZHIT 8

Neni 13

Numri i arbitërve

Neni 14

Emërimi i arbitërve

Neni 15	
Emërimi i arbitërve në procedurë shumëpalëshe	9
Neni 16	
Paanshmëria dhe pavarësia e arbitërve	10
Neni 17	
Konfirmimi i arbitërve	
Neni 18	
Kundërshtimi i arbitërve	
Neni 19	
Lirimi dhe zëvendësimi i arbitërve	11
<b>PROCEDURA PARA TRIBUNALIT TË ARBITRAZHIT</b>	<b>12</b>
Neni 20	
Përcjellja e dosjes te Tribunali i Arbitrazhit	
Neni 21	
Udhëheqja e procedurës	
Neni 22	
Vendi i arbitrazhit	13
Neni 23	
Gjuha e procedurës	
Neni 24	
Ligji i zbatueshëm	
Neni 25	
Orari procedural	14
Neni 26	
Padia	
Neni 27	
Deklarata e Mbrojtjes	15
Neni 28	
Parashtresat e tjera	
Neni 29	
Ndryshimet	
Neni 30	
Kompetenca e Tribunalit të Arbitrazhit	16
Neni 31	
Dëshmitë	
Neni 32	
Seancat dëgjimore	17

Neni 33	
Dëshmitarët	
Neni 34	
Ekspertët e emëruar nga Tribunali i Arbitrazhit	
Article 35	
Mungesa e përgjigjes	18
Neni 36	
Heqja dorë nga e drejta për të kundërshtuar	
Neni 37	
Masat e përkohshme	19
Neni 38	
Arbitri urgjent	
Neni 39	
Mbyllja e procedurës	20

## **VENDIMI I ARBITRAZHIT** **20**

Neni 40	
Marrja e vendimit të arbitrazhit dhe vendimeve tjera	
Neni 41	
Forma dhe efekti i vendimit të arbitrazhit	
Neni 42	
Afati kohor për vendimin përfundimtar	21
Neni 43	
Marrëveshja dhe bazat e tjera për përfundimin e procedurës	
Neni 44	
Korrigjimi dhe interpretimi i vendimit të arbitrazhit dhe vendimit shtesë	22

## **SHPENZIMET E PROCEDURËS SË ARBITRAZHIT** **23**

Neni 45	
Shpenzimet e arbitrazhit	
Neni 46	
Shpenzimet e bëra nga palët	24
Neni 47	
Paradhënia e shpenzimeve të arbitrazhit	

## **PROCEDURA E PËRSHPEJTUAR E ARBITRAZHIT** **25**

Neni 48	
Rregullat për Procedurën e Përsheptuar të Arbitrazhit	

## **RREGULLAT E PËRGJITHSHME** **27**

Neni 49

Rregullat e përgjithshme

Neni 50

Konfidencialiteti

Neni 51

Verzioni gjuhësor i Rregullave

Neni 52

Përrjashtimi i përgjegjësisë 28

Neni 53

Hyrja në fuqi

## **SHTOJCË I** **ORGANIZIMI I QAL** **31**

Neni 1

QAL

Neni 2

Funksionet e QAL

Neni 3

Bordi

Neni 4

Emërimi i Bordit 32

Neni 5

Sekretariati

Neni 6

Emërimi i Sekretarit Gjeneral 33

Neni 7

Puna e QAL

## **SHTOJCË II** **TABELA E SHPENZIMEVE** **34**

Neni 1

Tarifa e regjistrimit

Neni 2

Tarifat e Tribunalit të Arbitrazhit

Neni 3

Tarifa Administrative e QAL 35



Neni 4	
Shpenzimet e Tribunalit të Arbitrazhit dhe të QAL	35

### **SHTOJCË III**

#### **PROCEDURA E ARBITRIT URGJENT**

**38**

Neni 1	
Arbitri Urgjent	
Neni 2	
Zbatimi i Procedurës së Arbitrit Urgjent	
Neni 3	
Emërimi i Arbitrit Urgjent	39
Neni 4	
Vendi i Procedurës së Arbitrit Urgjent	40
Neni 5	
Udhëheqja e Procedurës së Arbitrit Urgjent	
Neni 6	
Vendimet mbi masat e përkohshme	
Neni 7	
Efekti i masës së përkohshme	41
Neni 8	
Shpenzimet e Procedurës së Arbitrit Urgjent	
Neni 9	
Rregulla e përgjithshme	42

### **SHTOJCË IV**

#### **Tabela e Shpenzimeve për procedurën e përsheptuar të arbitrazhit sipas Nenet 48 të Rregullave të Arbitrazhit të Qendrës së Arbitrazhit të Lubjanës në Odën e Tregtisë dhe Industrisë së Sllovenisë**

**43**

Neni 1	
Tarifa e regjistrimit	
Neni 2	
Tarifat e Tribunalit të Arbitrazhit	
Neni 3	
Tarifa Administrative e QAL	44
Neni 4	
Shpenzimet e Tribunalit të Arbitrazhit dhe të QAL	

Neni 5	
Hyrja në fuqi	44
<b>KLAUZOLAT STANDARDE TË ARBITRAZHIT</b>	<b>47</b>
Arbitrazhi	49
Arbitrazhi i Përshpejtuar	50
Arbitrazhi pa Arbitër Urgjent	51
Si të përdorni klauzolat standarde të arbitrazhit të QAL	52

R R E G U L L A T E  
A R B I T R A Z H I T  
TË QENDRËS SË ARBITRAZHIT NË ODËN E  
TREGTISË DHE INDUSTRIË SË SLLOVENISË



# DISPOZITAT HYRËSE

## Neni 1

### QAL

Qendra e Arbitrazhit e Lubjanës në Odën e Tregtisë dhe Industrisë së Sllovenisë (QAL), poashtu e njohur si Gjykata e Përhershme e Arbitrazhit pranë Odës së Tregtisë dhe Industrisë së Sllovenisë, është institucion autonom dhe i pavarur i cili administron zgjidhjen e kontesteve vendore dhe ndërkombëtare në përputhje me Rregullat e Arbitrazhit të Qendrës së Arbitrazhit të Lubjanës në Odën e Tregtisë dhe Industrisë së Sllovenisë (Rregullat), poashtu të njohura si Rregullat e Arbitrazhit të Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit pranë Odës së Eknomisë dhe Industrisë së Sllovenisë, si dhe rregullat dhe procedurat e tjera të dakorduara nga palët. QAL përbëhet nga Bordi dhe Sekretariati. Dispozitat mbi organizimin e QAL janë të përfshira në Shtojcën I.

## Neni 2

### Fusha e zbatimit

1. Kur palët janë pajtuar të paraqesin mosmarrëveshjen e tyre para një Tribunali të Arbitrazhit të themeluar në pajtim me këto Rregulla apo që mosmarrëveshjen e tyre ta referojnë tek QAL, do të konsiderohet se janë pajtuar për këto Rregulla, me kusht që procedura të fillojë pas hyrjes në fuqi të këtyre Rregullave.
2. Shtojcat I, II dhe III janë pjesë e këtyre Rregullave.
3. Kur marrëveshja e arbitrazhit është nënshkruar para hyrjes në fuqi të këtyre Rregullave, neni 11 dhe 12 dhe Shtojca III nuk do të zbatohen, përveç nëse palët janë pajtuar ndryshe.

## Neni 3

### Komunikimi me QAL

Komunikimi në mes të palëve dhe të QAL do të bëhet në gjuhën Sllovene apo Angleze.

# FILLIMI I PROCEDURËS SË ARBITRAZHIT

## Neni 4

### Fillimi i procedurës

Procedura do të fillojë atëherë kur Kërkesa për Arbitrazh pranohet nga QAL.

## Neni 5

### Kërkesa për Arbitrazh

1. Kërkesa për Arbitrazh duhet të përfshijë:
  - i. emrat, adresat dhe detajet kontaktuese (adresa elektronike, numri i telefonit dhe numri i faksit) të palëve dhe përfaqësuesve të tyre;
  - ii. një kopje të marrëveshjes së arbitrazhit ose, në mungesë të një dokumenti i cili përmban marrëveshjen e arbitrazhit, një përshkrim dhe çfardo dëshmie të ekzistencës së marrëveshjes së arbitrazhit;
  - iii. përshkrimin e mosmarrëveshjes dhe rrethanat që kanë ndikuar në lindjen e kërkesës;
  - iv. kërkesën për kompenzim;
  - v. një vlerë të përafërt monetare të kërkesës, kur kërkesa nuk ka të bëjë me një shumë të caktuar parash;
  - vi. propozimin lidhur me numrin e arbitërve, gjuhën e procedurës dhe vendin e arbitrazhit, nëse palët nuk janë pajtuar më herët lidhur me këtë;
  - vii. emërimin e një apo më shumë arbitërve nëse kjo kërkohet me marrëveshjen e arbitrazhit; dhe
  - viii. dëshmi të pagesës së tarifës së regjistrimit.
2. Në qoftë se Kërkesa për Arbitrazh nuk është në përputhje me kërkesat e paragrafit 1, Sekretariati mund të udhëzojë Paditësin që të bëjë korigjimin e Kërkesës për Arbitrazh brenda afatit të përcaktuar nga Sekretariati. Në qoftë se Paditësi nuk vepron në përputhje me udhëzimin, Sekretariati mund të përfundojë procedurën.
3. Së bashku me Kërkesën për Arbitrazh, Paditësi duhet të dorëzojë numrin e identifikimit tatimor të tij (nëse ka) ose një mjet tjetër të përshtatshëm të identifikimit për qëllim të tatimit mbi vlerën e shtuar.

## Neni 6

### Tarifa e Regjistrimit

1. Me paraqitjen e Kërkesës për Arbitrazh, Paditësi duhet të paguajë tarifën e regjistrimit, në përputhje me Shtojcën II.
2. Sekretariati nuk do të dërgojë Kërkesën për Arbitrazh tek i Padituri, deri sa të bëhet pagesa e tarifës së regjistrimit.
3. Nëse Paditësi dështon të paguajë tarifën e regjistrimit, Sekretariati do të caktojë një afat për pagesë. Nëse tarifa e regjistrimit nuk paguhet brenda këtij afati, Sekretariati mund të përfundojë procedurën.

## Neni 7

### Përgjigja në Kërkesën për Arbitrazh

1. Sekretariati do të dërgojë Kërkesën për Arbitrazh te i Padituri dhe do të ftojë të Paditurin që të dorëzoj Përgjigjen ndaj Kërkesës për Arbitrazh brenda 30 ditëve.
2. Përgjigja në Kërkesën për Arbitrazh duhet të përfshijë:
  - i. emrat, adresat dhe detajet kontaktuese (adresa elektronike, numri i telefonit dhe numri i faksit të palëve dhe përfaqësuesve të tyre;
  - ii. çfardo kundërshtimi mbi kompetencën e Tribunalit të Arbitrazhit i cili do të themelohet sipas këtyre Rregullave;
  - iii. komentet mbi deklaratat e bëra nga Paditësi;
  - iv. kërkesën për kompenzim;
  - v. një vlerë të përafërt monetare të kërkesës, kur kërkesa nuk ka të bëjë me një shumë të caktuar parash;
  - vi. propozimi lidhur me numrin e arbitërve, gjuhën e procedurës dhe vendin e arbitrazhit, nëse palët nuk janë pajtuar më herët lidhur me këtë; dhe
  - vii. nominimin e një apo më shumë arbitërve nëse kjo kërkohet me marrëveshjen e arbitrazhit.
3. Si rregull, i Padituri duhet të bëjë çfardo kundërpadië ose padi për kompenzimin e ndërsjellë me paraqitjen e Përgjigjes në Kërkesën për Arbitrazh. Për kundërpadië dhe padi të kompenzimit të ndërsjelltë do të zbatohet Neni 5 *mutatis mutandis*.

4. Së bashku me Përgjigjen ndaj Kërkesës për Arbitrazh, i Padituri duhet të dorëzojë numrin e identifikimit tatimor të tij (nëse ka) ose një mjet tjetër të përshtatshëm të identifikimit për qëllim të tatimit mbi vlerën e shtuar.
5. Nëse i Padituri dështon të parashtojë Përgjigjen në Kërkesën për Arbitrazh procedura do të vazhdojë në bazë të këtyre rregullave.

## Neni 8

### Afatet kohore

1. Çdo njoftim ose komunikim tjetër i dërguar në përputhje me Nenin 9 në ditën ose para ditës së fundit të periudhës kohore, do të konsiderohet se është dërguar me kohë.
2. Afati do të fillojë të rrjedhë nga dita pas ditës në të cilën njoftimi ose komunikimi konsiderohet se është pranuar në përputhje me Nenin 9. Në qoftë se kjo ditë është festë zyrtare ose ditë pushimi në vendbanimin ose vendin e biznesit të adresuarit, afati kohor do të fillojë të rrjedhë nga dita e parë e punës që vijon. Festat zyrtare dhe ditët e pushimit të cilat ndodhin gjatë periudhës kohore janë të përfshira në llogaritjen e afatit. Kur dita e fundit e një periudhe kohore është festë zyrtare ose ditë pushimi në vendbanimin ose vendin e biznesit të adresuarit, afati mbaron në ditën e parë vijuese të punës.
3. QAL me kërkesë të njëjës palë apo me iniciativën e saj, mund të zgjasë apo të shkurtojë çdo afat, të cilin e ka përcaktuar apo të cilin ka autoritet për të përcaktuar ose ndryshuar.

## Neni 9

### Njoftimet dhe komunikimet

1. Të gjitha njoftimet dhe komunikimet do të dërgohen në adresën e fundit të njohur të të adresuarit. Njoftimet dhe komunikimet mund të dërgohen me korrier, me postë të regjistruar, e-mail, faks ose mjet tjetër të telekomunikimit i cili siguron një dëshmi të dërgesës.
2. Kur pala ka caktuar përfaqësuesin, çdo njoftim ose komunikim tjetër i dorëzuar te përfaqësuesi do të konsiderohet si të i ishte komunikuar palës.
3. Një njoftim ose komunikim do të konsiderohet se është pranuar në ditën kur i është dorëzuar fizikisht të adresuarit



ose në ditën kur do të konsiderohet të jetë pranuar në bazë të mjeteve të telekomunikimit të përmendura në paragrafin 1.

4. Të gjitha njoftimet dhe komunikimet (së bashku me çfardo shtojce) duhet të dorëzohen në numër të mjaftueshëm kopjesh për QAL, për secilën nga palët dhe secilin prej arbitërve, përveç nëse janë dorëzuar në mënyrë elektronike.
5. Para që Sekretariati të përcjell lëndën tek Tribunali i Arbitrazhit, palët duhet të dërgojnë të gjitha njoftimet dhe komunikimet te QAL. Pasi që palët të jenë njoftuar për përcjelljen e lëndës te Tribunali i Arbitrazhit, ata duhet të dërgojnë të gjitha njoftimet dhe komunikimet drejtpërdrejtë dhe njëkohësisht te Tribunali dhe pala tjetër si dhe të kopjojnë QAL.

## Neni 10

### Refuzimi për të administruar rastin

Bordi mund të refuzojë administrimin e një rasti në qoftë se është e qartë *prima facie* se nuk ka juridiksion mbi mosmarrëveshjen sipas këtyre Rregullave ose palët janë pajtuar për rregulla procedurale të cilat devijojnë nga këto Rregulla në një shkallë të tillë që procedura do të vështirësohej në mënyrë disproporcionale.

## Neni 11

### Shkrirja

1. Me kërkesë të një pale, Bordi mund të shkrij dy apo më tepër raste të ndara dhe ende të pazgjidhura sipas këtyre Rregullave, kur:
  - i. të gjitha palët janë pajtuar për shkrirje; apo
  - ii. të gjitha pretendimet në këto raste janë të mbuluara nga e njejta marrëveshje e arbitrazhit; apo
  - iii. jo të gjitha pretendimet në këto raste janë të mbuluara nga e njejta marrëveshje e arbitrazhit, nëse rastet janë në mes të palëve të njejta, pretendimet kanë lindur nga e njejta marrëdhënie juridike dhe Bordi konsideron se marrëveshjet e arbitrazhit janë në pajtueshmëri.
2. Gjatë marrjes së vendimit për shkrirje, Bordi do të marrë parasysh të gjitha rrethanat të cilat i konsideron të rëndësishme, duke përfshirë edhe atë nëse ndonjë arbitër është emëruar në më shumë se një nga rastet, dhe nëse po,

nëse janë emëruar arbitrit e njëjtë ose të ndryshëm. Para miratimit të vendimit për shkrimje Bordi duhet të këshillohet me palët dhe arbitrit tashmë të emëruar.

3. Rastet do të shkrihen në rastin i cili ka filluar i pari, përveç nëse të gjitha palët pajtohen ndryshe.

### Neni 12

#### Bashkimi

Me kërkesë të cilësdo palë, Tribunali i Arbitrazhit mund të lejojë që një ose më shumë persona të tretë të bashkohen si palë në procedurë me kusht që personi i tillë të jetë i detyruar nga marrëveshja e arbitrazhit. Tribunali i Arbitrazhit, pasi ti ketë dhënë mundësinë e paraqitjes së komenteve të gjitha palëve, duke përfshirë edhe personin ose personat që do të bashkohen, mund të vendos që të mos lejoj bashkimin, nëse duke bërë kështu mund të i shkaktojë dëmtim joproporcional ndonjëres prej palëve.

## THEMELIMI I TRIBUNALIT TË ARBITRAZHIT

### Neni 13

#### Numri i arbitërve

Palët mund të pajtohen për numrin e arbitërve. Kur palët nuk janë pajtuar për numrin e arbitërve, mosmarrëveshja duhet të vendoset nga një panel prej tre arbitërve, përveç nëse, duke marrë parasysh kompleksitetin e çështjes, vlerën e mosmarrëveshjes ose rrethana të tjera, Bordi vendos se mosmarrëveshja duhet të vendoset nga një arbitër i vetëm.

### Neni 14

#### Emërimi i arbitërve

1. Palët mund të pajtohen për një procedurë ndryshe të emërimit të arbitërve nga ajo e cila parashikohet me këto rregulla. Në raste të tilla, nëse Tribunali i Arbitrazhit nuk është emëruar brenda afatit për të cilin janë pajtuar palët ose kur palët nuk janë pajtuar për afatin, brenda afatit të përcaktuar nga Sekretariati, arbitrit do të emërohen në bazë të neneve 14 dhe 15.

2. Kur Tribunali i Arbitrazhit do të përbëhet nga një arbitër i vetëm, palët duhet të nominojnë arbitrin bashkarisht. Nëse palët nuk e bëjnë këtë, Sekretariati do të caktojë një afat për nominimin. Nëse arbitri i vetëm nuk nominohet brenda këtij afati kohor, emërimi do të bëhet nga Bordi.
3. Kur Tribunali i Arbitrazhit do të përbëhet prej më shumë se një arbitri, secila palë duhet të nominoj numër të barabartë të arbitërve. Arbitrit e nominuar në këtë mënyrë, pas konfirmimit të tyre, sipas udhëzimit të Sekretariatit, në afat prej 15 ditë duhet të nominojnë arbitrin i cili do të veproj si Kryesues i Tribunalit të Arbitrazhit. Kur ndonjëri prej arbitërve nuk nominohet brenda afatit për të cilin janë pajtuar palët apo të i cili është përcaktuar nga Sekretariati, emërimi duhet të bëhet nga Bordi.
4. Arbitrit e nominuar i nënshtrohen konfirmimit në pajtim me Nenin 17. Pas konfirmimit, arbitri i nominuar do të konsiderohet si i emëruar. Arbitrit kanë marrëdhënie kontraktuale me palët dhe i ofrojnë shërbimet e tyre për palët.
5. Në procesin e emërimit të arbitrit sipas këtyre rregullave, Bordi do të marrë parasysh natyrën e mosmarrëveshjes, ligjin e zbatueshëm, vendin e arbitrazhit, gjuhën e procedurës, kombësinë e palëve dhe rrethanat e tjera të rastit.

## Neni 15

### Emërimi i arbitërve në procedurë shumëpalëshe

1. Në rastet me Paditës dhe të Paditur të shumtë, arbitrit do të emërohen në bazë të Nenit 14, përveç nëse parashikohet ndryshe me këto Rregulla.
2. Kur Tribunali i Arbitrazhit do të përbëhet prej më shumë se një arbitri, ndërsa ka Paditës dhe të Paditur të shumtë, Paditësit së bashku dhe të Paditurit së bashku, duhet të nominojnë numër të barabartë të arbitërve. Nëse njëra nga palët nuk bën nominimin e përbashkët brenda afatit të dakorduar nga palët ose të caktuar nga Sekretariati, arbitri ose arbitrit do të emërohen nga Bordi. Në rrethana të jashtëzakonshme, pasi të i ketë dhënë palëve mundësinë për të paraqitur komentet, Bordi mund të revokoj emërimet e bëra dhe të emëroj një arbitër të ri ose të gjithë arbitrit dhe në mesin e tyre të caktojë arbitrin i cili do të veproj si Kryesues i Tribunalit të Arbitrazhit.

## Neni 16

### Paanshmëria dhe pavarësia e arbitërve

1. Çdo arbitër duhet të jetë i paanshëm dhe i pavarur.
2. Një person i nominuar si arbitër duhet t'i paraqesë Sekretariatit një deklaratë të nënshkruar të pranimit, disponueshmërisë, paanshmërisë dhe pavarësisë, ku ai ose ajo zbulon çfardo rrethane e cila mund të sjell dyshime të arsyeshme në lidhje me paanshmërinë apo pavarësinë e tij ose të saj. Sekretariati duhet të dërgojë një kopje të deklaratës për palët dhe arbitrit e tjerë dhe të vendos një afat, brenda të cilit ata mund të paraqesin komente.
3. Kur çfardo rrethane nga paragrafi 2 lind përgjatë procedurës, arbitri menjëherë duhet të informojë palët, arbitrit e tjerë dhe QAL me shkrim.

## Neni 17

### Konfirmimi i arbitërve

1. Konfirmimi i një arbitri të nominuar do të bëhet nga Sekretariati. Duke vepruar kështu, Sekretariati duhet të marrë në konsideratë deklaratën e referuar në Nenin 16 (2) dhe të gjitha rrethanat të cilat mund të ngrisin dyshime lidhur me paanshmërinë apo pavarësinë e arbitrit, disponueshmërinë dhe aftësinë për të udhëhequr procedurën në mënyrë të përshtatshme dhe pa vonesa dhe çfardo komenti nga palët. Sekretariati nuk ka asnjë detyrim të jep arsytet për vendimin e tij.
2. Kur një nominim nuk është konfirmuar, Sekretariati duhet të udhëzoj partinë apo arbitrit që të bëjnë nominim të ri në afat të përcaktuar nga Sekretariati. Në rrethana të jashtëzakonshme, arbitri mund të emërohet drejtpërdrejtë nga Bordi, pas konsultimit paraprak me palët dhe arbitrit tjerë.
3. Pas konfirmimit të të gjithë arbitërve të nominuar, bëhet themelimi i Tribunalit të Arbitrazhit. Sekretariati duhet të njoftojë palët lidhur me këtë.

## Neni 18

### Kundërshtimi i arbitërve

1. Një arbitër mund të kundërshtohet nëse ekzistojnë rrethanat të cilat ngrisin dyshime të arsyeshme për paanshmërinë ose pavarësinë e tij apo saj, ose kur arbitri nuk i posedon

kualifikimet të rëna dakord nga palët. Një palë mund të kundërshtojë një arbitër të cilin ajo e ka nominuar ose në nominimin e të cilit ka marrë pjesë, vetëm për arsye për të cilat pala u bë e vetëdijshme pas nominimit.

2. Një palë mund të kundërshtojë një arbitër brenda 15 ditëve pasi që rrethanat e përmendura në paragrafin 1 i janë bërë të njohura asaj pale. Dështimi nga një palë për të kundërshtuar arbitrin brenda kësaj periudhe përbën heqje dorë nga e drejta për të kundërshtuar.
3. Pala e cila bën kundërshtimin e arbitrit duhet të dërgojë njoftimin e kundërshtimit tek Sekretariati. Njoftimi duhet të bëhet me shkrim dhe të përmbajë arsyet për kundërshtimin.
4. Sekretariati do të njoftojë arbitrin e kundërshtuar, palët e tjera dhe arbitrit e tjerë mbi kundërshtimin si dhe të vendos afatin brenda të cilit ata mund të dorëzojnë komentet mbi kundërshtimin.
5. Nëse palët e tjera pajtohen me kundërshtimin apo arbitri i kundërshtuar tërhiqet, në përputhje me Nenin 19 duhet të emërohet arbitri zëvendësues. Tërheqja e arbitrit apo pajtimi i palëve të tjera mbi kundërshtimin nuk nënkupton pranimin e vlefshmërisë së arsyeve për kundërshtimin.
6. Nëse palët e tjera nuk pajtohen me kundërshtimin dhe arbitri i kundërshtuar nuk tërhiqet, mbi kundërshtimin do të vendos Bordi. Bordi nuk ka detyrim të jap arsye për vendimin e tij.

## Neni 19

### Lirimi dhe zëvendësimi i arbitërve

1. Bordi do të lirojë arbitrin nga emërimi kur:
  - i. të gjitha palët pajtohen për lirimin e arbitrit; ose
  - ii. arbitri parandalohet de jure apo de facto nga përmbushja e funksioneve të tij ose saj ose dështon të kryej ato në përputhje me këto Rregulla; ose
  - iii. pranon tërheqjen e arbitrit; ose
  - iv. mbështet kundërshtimin e arbitrit sipas Nenit 18.
2. Para marrjes së vendimit sipas paragrafit 1(ii), Bordi mund të ju jap palëve dhe arbitërve mundësinë e dorëzimit të komenteve ndaj lirimit. Bordi nuk ka detyrim të jap arsye për vendimin e tij mbi lirimin.

3. Kur arbitri lirohet nga emërimi ose kur arbitri vdes përgjatë rrjedhës së procedurës, dispozitat e Nenit 13 -17 do të zbatohen *mutatis mutandis* për emërimin e arbitrit zëvendës.
4. Kur Tribunali i Arbitrazhit përbëhet nga më shumë se një arbitër, në rrethana të jashtëzakonshme, Bordi mund të vendos që arbitrit e mbetur të vazhdojnë me procedurën dhe të marrin çfardo vendimi apo vendimin e arbitrazhit. Duke bërë kështu, Bordi do të merr parasysht fazën aktuale të procedurës dhe çfardo rrethane tjetër të rastit. Para marrjes së vendimit, Bordi do të këshillohet me palët dhe arbitrit e mbetur.
5. Kur një arbitër është zëvendësuar, Tribunali i Arbitrazhit i sapo përbërë do të vendos nëse dhe deri në çfarë mase do të përsëritet procedura.

## PROCEDURA PARA TRIBUNALIT TË ARBITRAZHIT

### Neni 20

#### **Përcjellja e dosjes te Tribunali i Arbitrazhit**

Sapo të jetë themeluar Tribunali i Arbitrazhit dhe të jetë bërë pagesa e paradhënies së shpenzimeve, Sekretariati do të përcjellë dosjen te Tribunali i Arbitrazhit.

### Neni 21

#### **Udhëheqja e procedurës**

1. Tribunali i Arbitrazhit duhet të udhëheq procedurën në përputhje me këto Rregulla dhe me pajtimin e palëve në atë mënyrë siç e konsideron të përshtatshme, me kusht që palët të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe se në fazën e duhur të procedurës secilës palë të i jepet mundësia e arsyeshme që të prezantoj rastin e tij. Tribunali i Arbitrazhit gjatë ushtrimit të diskrecionit të tij duhet të udhëheq procedurën ashtu që të evitohet shpenzimet dhe vonesat e panevojshme dhe të ofrojë proces të drejtë dhe efikas për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.
2. Të gjithë pjesëmarrësit në procedurë duhet të veprojnë në mirëbesim dhe të bëjnë secilën përpjekje të mundshme për udhëheqjen efikase të procedurës dhe të evitohet shpenzimet dhe vonesat e panevojshme. Kur pala dështon të përmbushë

detyrimet e saj sipas kësaj dispozite, Tribunali i Arbitrazhit mund të marr parasysht këtë dështim gjatë ndarjes së shpenzimeve të procedurës së arbitrazhit në mes të palëve.

## Neni 22

### Vendi i arbitrazhit

1. Kur palët nuk janë pajtuar lidhur me vendin e arbitrazhit, kjo do të përcaktohet nga Bordi, përveç nëse, duke pasur parasysht rrethanat e rastit, Bordi e sheh më të përshtatshme që vendi i arbitrazhit të përcaktohet nga Tribunali i Arbitrazhit.
2. Tribunali i arbitrazhit, pas këshillimit paraprak me palët, mund të mbajë seancat dëgjimore ose çfardo veprimi tjetër procedural në çfardo lokacioni të cilin e konsideron të përshtatshëm.
3. Tribunali i Arbitrazhit mund të takohet dhe të diskutojë në çfardo lokacioni të cilin e konsideron të përshtatshëm.
4. Vendimi i arbitrazhit do të konsiderohet se është bërë në vendin e arbitrazhit.

## Neni 23

### Gjuha e procedurës

1. Nëse palët nuk janë pajtuar lidhur me gjuhën ose gjuhët e procedurës, kjo duhet të përcaktohet nga Tribunali i Arbitrazhit shumë shpejtë pas themelimit të tij. Duke bërë kështu, Tribunali i Arbitrazhit duhet të marr parasysht rrethanat e rastit dhe të ju ofrojë palëve mundësinë që të dorëzojnë komentet.
2. Tribunali i Arbitrazhit mund të urdhërojë që secili dokument apo provë të përcjellet me përkthim në gjuhën apo gjuhët e procedurës.

## Neni 24

### Ligji i zbatueshëm

1. Tribunali i Arbitrazhit duhet të vendos mbi rastin në përputhje me dispozitat ligjore të zgjedhura nga palët si të zbatueshme për pjesën materiale të mosmarrëveshjes. Çfardo përzgjedhje e ligjit ose sistemit ligjor të një shteti duhet të konsiderohet se i referohet ligjit material të atij shteti dhe jo dispozitave të konfliktit të ligjit.

2. Në mungesë të pajtimit të palëve, Tribunali i Arbitrazhit duhet të vendos në përputhje me rregullat e ligjit të cilin e përcakton si të përshtatshëm.
3. Tribunali i Arbitrazhit mund të vendos si *amiable compositeur* ose *ex aequo et bono* vetëm nëse palët shprehimisht e kanë autorizuar të veprojnë kështu.
4. Tribunali i Arbitrazhit duhet të vendos në përputhje me kushtet e kontratës dhe duhet të marr parasysh uzancat tregtare relevante.

## Neni 25

### Orari procedural

1. Pasi që dosja të jetë përcjellur te Tribunali i Arbitrazhit, menjëherë pas këshillimit paraprak me palët, Tribunali duhet të vendos orarin procedural për udhëheqjen e procedurës.
2. Përmes orarit procedural, Tribunali i Arbitrazhit duhet të vendos afatet për dorëzimin e Padisë dhe Deklaratës së Mbrojtjes si dhe parashtresat e tjera, datën (datat) e seancave dëgjimore, datën deri në të cilën Tribunali i Arbitrazhit duhet të merr vendimin përfundimtar dhe çështje të tjera të cilat i konsideron të nevojshme.
3. Tribunali i Arbitrazhit duhet të ju komunikojë palëve dhe QAL orarin procedural dhe çdo ndryshim të bërë në orar.

## Neni 26

### Padia

1. Paditësi duhet të dorëzojë Padinë tek i Padituri, secili prej arbitërve dhe QAL brenda periudhës kohore të përcaktuar nga Tribunali i Arbitrazhit.
2. Përveç nëse është e përfshirë në Kërkesën për Arbitrazh, Padia duhet të përmbajë:
  - i. kërkesën për kompenzim; dhe
  - ii. përmbledhjen e fakteve dhe të bazës ligjore në mbështetje të kërkesës.
3. Për aq sa është e mundshme, Padia duhet të përcjellet nga të gjitha dokumentet dhe provat e tjera në të cilat mbështetet Paditësi.



## Neni 27

### Deklarata e Mbrojtjes

1. I Padituri duhet të dorëzojë Deklaratën e Mbrojtjes te Paditësi, secili prej arbitërve dhe QAL brenda periudhës kohore të përcaktuar nga Tribunali i Arbitrazhit.
2. Përveç nëse janë pjesë e Përgjigjes në Kërkesën për Arbitrazh, Deklarata e Mbrojtjes duhet të përfshijë:
  - i. një deklaratë nëse dhe deri në çfarë mase i Padituri pranon apo refuzon kërkesën për kompenzim të kërkuar nga Paditësi; dhe
  - ii. një përmbledhje të fakteve dhe bazës ligjore në mbështetje të mbrojtjes.
3. Për aq sa është e mundshme, Deklarata e Mbrojtjes duhet të përcjellet me të gjitha dokumentet dhe provat e tjera në të cilat mbështetet i Padituri.
4. Dispozitat e Nenit 26 do të aplikohen *mutatis mutandis* ndaj kundërpadisë dhe padisë për kompenzim të ndërsjelltë.

## Neni 28

### Parashtresat e tjera

Tribunali i Arbitrazhit, pas këshillimit paraprak me palët, mund të vendos se cilat parashtresa të mëtutjeshme, përveç Padisë dhe Deklaratës së Mbrojtjes, duhet të dorëzohen nga palët dhe të përcaktoj afatet kohore për dorëzimin e tyre.

## Neni 29

### Ndryshimet

Kur palët nuk janë pajtuar ndryshe, përgjatë procedurës, pala mund të ndryshojë apo plotësojë kërkesën e saj, mbrojtjen, kundërpadinë apo padinë për kompenzim të ndërsjelltë, me kusht që rasti, edhe pas ndryshimit dhe plotësimit të mbetet i mbuluar nga marrëveshja e arbitrazhit. Tribunali i Arbitrazhit nuk do të lejojë ndryshimin dhe plotësimin nëse konsideron se ky ndryshim dhe plotësim në mënyrë disproporcionale do të shkaktojë vonesë në procedurë ose do të shkaktojë paragjykim ndaj palëve të tjera ose çfardo rrethane tjetër legjitime.

## Neni 30

### Kompetenca e Tribunalit të Arbitrazhit

1. Tribunali i Arbitrazhit ka kompetencë që të vendos mbi kompetencën e tij, përfshirë çfardo kundërshtimi lidhur me ekzistencën apo vlerfshmërinë e marrëveshjes së arbitrazhit.
2. Pretendimi se Tribunali i Arbitrazhit nuk ka kompetencë duhet të ngritet jo më larg se me Deklaratën e Mbrojtjes ose, kur bëhet fjalë për kundërpadinë dhe padinë për kompenzim të ndërsjelltë, me përgjigjen në kundërpadi dhe padinë për kompenzim të ndërsjelltë. Pala nuk parandalohet prej ngritjes së një argumenti të tillë nga fakti se ka nominuar ose marrë pjesë në emërimin e një arbitri. Pretendimi se Tribunali i Arbitrazhit ka tejkaluar fushëveprimin e autoritetit të tij duhet të ngritet sapo që çështja e cila pretendohet të jetë jashtë fushëveprimit të autoritetit të tij të ngritet përgjatë procedurës. Tribunali i Arbitrazhit, në secilin rast, mund të pranojë një pretendim të mëvonshëm nëse konsideron se vonesa është e arsyeshme.
3. Tribunali i Arbitrazhit mund të vendos mbi kompetencën e tij përmes vendimit të arbitrazhit apo ndonjë vendimi tjetër. Tribunali i Arbitrazhit mund të vazhdojë procedurën dhe të merr vendimin përfundimtar pavarësisht çfardo kundërshtimi ndaj kompetencës së tij para autoritetit gjyqësor.

## Neni 31

### Dëshmitë

1. Tribunali i Arbitrazhit duhet të përcaktojë pranueshmërinë, relevancën, rëndësinë dhe peshën e secilës dëshmi.
2. Në çfardo kohe përgjatë procedurës, Tribunali i Arbitrazhit mund të kërkojë nga cilado palë brenda një periudhe të caktuar kohore:
  - i. të identifikojë dëshmitë në të cilat pala mbështetet dhe të specifikojë rrethanat të cilat duhet të dëshmohen nga provat e tilla;
  - ii. të paraqesin çfardo dokumenti apo dëshmie tjetër të cilën Tribunali i Arbitrazhit mund ta konsiderojë relevante për rezultatin e rastit.

**Neni 32****Seancat dëgjimore**

1. Një seancë dëgjimore do të mbahet nëse ajo kërkohet nga një palë, apo nëse konsiderohet e përshtatshme nga Tribunali i Arbitrazhit.
2. Tribunali i Arbitrazhit duhet të ju jep palëve njoftim të mjaftueshëm paraprak të datës, orës, dhe vendit të mbajtjes së seancës.
3. Seancat dëgjimore do të mbahen të mbyllura përveç nëse palët pajtohen ndryshe.
4. Tribunali i Arbitrazhit duhet të përcaktojë nëse dhe në cilën formë duhet të përgatitet procesverbali i seancës dëgjimore.

**Neni 33****Dëshmitarët**

1. Dëshmitarët dhe ekspertët e emëruar nga palët (dëshmitarët ekspert) mund të dëgjojnë dhe ekzaminohen sipas kushteve dhe mënyrës së përcaktuar nga Tribunali i Arbitrazhit. Tribunali i Arbitrazhit mund të udhëzojë që dëshmitarët dhe dëshmitarët ekspert të ekzaminohen nëpërmjet mënyrave të telekomunikimit (p.sh. videokonferencë).
2. Para secilës seancë dëgjimore, Tribunali i Arbitrazhit mund të urdhërojë palët që të identifikojnë secilin dëshmitar apo dëshmitar ekspert të cilin kanë për qëllim ta thërrasin dhe të specifikojnë rrethanat që duhet të dëshmohen në secilën dëshmi.
3. Pas këshillimit paraprak me palët, Tribunali i Arbitrazhit mund të urdhërojë që, para seancës dëgjimore dhe brenda një periudhe kohore të përcaktuar nga Tribunali i Arbitrazhit, të prezantohet një dëshmi individuale në formë të një deklaratë të shkruar dhe të nënshkruar.

**Neni 34****Ekspertët e emëruar nga Tribunali i Arbitrazhit**

1. Pas këshillimit paraprak me palët, Tribunali i Arbitrazhit mund të emërojë një apo më shumë ekspert që ti raportojnë atij, me shkrim, lidhur me çështje specifike të përcaktuara nga Tribunali i Arbitrazhit.
2. Tribunali i Arbitrazhit mund të urdhërojë palët që të parashtrojnë çfardo informate relevante pranë ekspertit dhe të dorëzojnë apo ofrojnë qasje në dokumente, sende, apo objekte për inspektim.

3. Pas pranimit të raportit të ekspertit, Tribunali i Arbitrazhit do të dërgojë një kopje të tij tek palët dhe të ju jep atyre mundësinë që të dorëzojnë komente me shkrim.
4. Me kërkesën e cilësdo palë, eksperti mund të ekzaminohet në seancë dëgjimore ku palët mund të marrin në pyetje ekspertin dhe të prezantojnë dëshmitar ekspert që të ofrojnë opinionin e tyre mbi çështjet në fjalë.

### Article 35

#### Mungesa e përgjigjes

1. Nëse Paditësi dështon të paraqes Padinë brenda afatit kohor pa arsytim të mjaftueshëm, Tribunali i Arbitrazhit do të përfundojë procedurën, përveç nëse ekzistojnë çështje të mbetura për të cilat duhet të vendoset dhe Tribunali e konsideron të përshtatshme që të bëjë këtë.
2. Nëse i Padituri dështon të paraqes Deklaratën e Mbrojtjes brenda afatit kohor pa arsytim të mjaftueshëm, Tribunali i Arbitrazhit do të vazhdojë procedurën pa trajtuar këtë dështim si pranim të pretendimeve të Paditësit.
3. Nëse pala e cila është njoftuar me rregull dështon të paraqitet në seancë dëgjimore pa arsytim të mjaftueshëm për këtë, Tribunali i Arbitrazhit mund të vazhdojë me procedurën.
4. Nëse pala e cila është ftuar me rregull që të paraqes dëshmi në formë dokumentesh apo në formë tjetër dështon të bëjë këtë pa arsytim të mjaftueshëm për këtë dështim, Tribunali i Arbitrazhit mund të merr vendimin e arbitrazhit në bazë të dëshmive të cilat i posedon.
5. Nëse pala dështon të veprojë në përputhje me çilëndo dispozitë të këtyre Rregullave apo një urdhëri apo udhëzimi të Tribunalit të Arbitrazhit pa arsytim të mjaftueshëm, Tribunali mund të nxjerrë konkluzione të cilat i konsideron të përshtatshme nga mosbindja e palës.

### Neni 36

#### Heqja dorë nga e drejta për të kundërshtuar

Pala e cila është në dijeni apo duhet të ishte në dijeni për çfardo mospërputhje me marrëveshjen e arbitrazhit, këto Rregulla apo çfardo rregulla të tjera të zbatueshme në procedurë dhe pavarësisht kësaj vazhdon të marrë pjesë në procedurë pa bërë kundërshtim të shpejtë ndaj kësaj mospërputhje do të konsiderohet të ketë hequr dorë nga e drejta për të bërë kundërshtimin.

**Neni 37****Masat e përkohshme**

1. Tribunali i Arbitrazhit, me kërkesë të një pale, mund të udhërojë masë të përkohshme nëse e konsideron të përshtatshme. Tribunali i Arbitrazhit mund të urdhërojë palët që të japin siguri të mjaftueshme në lidhje me masën.
2. Në rrethana të jashtëzakonshme, nëse konsiderohet me urgjencë, Tribunali i Arbitrazhit mund të urdhërojë masë të përkohshme para se ti jep palës tjetër mundësinë që të paraqes komente. Në raste të tilla, Tribunali i Arbitrazhit, sa më shpejtë të jetë e mundur, do tii jep pales tjetër mundësinë që të paraqes komente mbi bazën e të cilave do të shqyrtojë vendimin e tij për masën e përkohshme.
3. Me kërkesën e një pale apo, në rrethana të jashtëzakonshme dhe me njoftim paraprak për palët, me iniciativë të Tribunalit të Arbitrazhit, Tribunali mund të modifikojë, pezullojë apo përfundojë një masë të përkohshme të cilën e ka urdhëruar.
4. Duke u pajtuar për arbitrazh nën këto Rregulla, palët marrin përsipër që të përmbushin çfardo masë të përkohshme pa vonesë apo brenda afatit të përcaktuar nga Tribunali i Arbitrazhit. Pala e cila kërkon një masë të përkohshme do të mbajë përgjegjësi për shpenzimet dhe dëmin shkaktuar ndonjëherë palë nga kjo masë, nëse Tribunali i Arbitrazhit më vonë përcakton se, në rrethanat gjatë asaj kohe, masa nuk do të duhej të ishte urdhëruar. Tribunali i Arbitrazhit mund të urdhëroj shpenzime dhe dëme të tilla në çfardo faze përgjatë procedurës.
5. Kërkesa për një masë të përkohshme apo masë tjetër konservatore e adresuar nga një palë pranë një autoriteti gjyqësor nuk do të konsiderohet si në mospërputhje me marrëveshjen e arbitrazhit apo këto Rregulla, dhe as nuk përbën heqje dorë nga marrëveshja e arbitrazhit.

**Neni 38****Arbitri urgjent**

1. Pala e cila ka nevojë për një masë të përkohshme urgjente e cila nuk mund të pres themelimin e Tribunalit të Arbitrazhit mund të iniciojë Procedurën e Arbitrit Urgjent në përputhje me Shtojcën III.
2. Dispozitat për Procedurën e Arbitrit Urgjent nuk duhet të aplikohen nëse palët janë pajtuar të heqin dorë nga Shtojca III.

## Neni 39

### Mbyllja e procedurës

1. Tribunali i Arbitrazhit do të deklarojë mbylljen e procedurës kur të përcakton se palët kanë pasur mundësi të arsyeshme që të prezantojnë rastin e tyre.
2. Në raste të jashtëzakonshme, para marrjen së vendimit përfundimtar, Tribunali i Arbitrazhit mund të rihapë procedurën me propozim të tyre, apo me kërkesë të palës.

## VENDIMI I ARBITRAZHIT

## Neni 40

### Marrja e vendimit të arbitrazhit dhe vendimeve tjera

1. Kur Tribunali i Arbitrazhit përbëhet nga më shumë se një arbitër, çfardo vendimi i arbitrazhit apo vendimi tjetër do të bëhet me votim nga shumica e arbitërve. Kur nuk mund të arrihet shumica, vendimi i arbitrazhit apo ndonjë vendim tjetër do të bëhen nga Kryesuesi i Tribunalit të Arbitrazhit.
2. Tribunali i Arbitrazhit mund të merr vendime të veçanta lidhur me pretendime dhe çështje individuale.
3. Tribunali i Arbitrazhit mund të autorizojë Kryesuesin e tij që të vendosë mbi çfardo çështje të procedurës, për tu rishikuar nga Tribunali.
4. Kur cilido arbitër dështon pa arsyetim të mjaftushëm që të marr pjesë në shqyrtimet lidhur me marrjen e vendimit të arbitrazhit apo ndonjë vendimi tjetër, pas dhënies së mundësisë së arsyeshme që të bëj këtë, ky dështim nuk do të parandaloj marrjen e vendimit nga arbitrit e tjerë.

## Neni 41

### Forma dhe efekti i vendimit të arbitrazhit

1. Vendimi i arbitrazhit duhet të bëhet në formë të shkruar. Tribunali i Arbitrazhit duhet të theksojë arsyet në bazë të të cilave është bazuar vendimi, përveç nëse palët janë pajtuar se arsyet nuk do të jepen.
2. Vendimi i arbitrazhit do të jetë final dhe detyrues për palët. Kundrejt palëve, vendimi do të ketë efektin e një vendimi final dhe detyrues të gjykatës. Duke u pajtuar për arbitrazh

nën këto Rregulla palët marrin përsipër që të zbatojnë të gjitha vendimet pa vonesë apo brenda periudhës së theksuar brenda.

3. Vendimi i arbitrazhit duhet të nënshkruhet nga arbitrit, duhet të përmbajë datën në të cilën është lëshuar dhe të shënoj vendin e arbitrazhit në përputhje me Nenin 22. Kur Tribunali i Arbitrazhit përbëhet nga më shumë se një arbitër dhe njëri nga ta dështon ta nënshkruaj, vendimi duhet të përmbajë arsyet për mungesën e nënshkrimit.
4. Tribunali i Arbitrazhit, pa vonesë, do ti dërgojë vendimin e arbitrazhit Sekretariatit në numër të mjaftueshëm të kopjeve të nënshkruara për të gjitha palët dhe për QAL.
5. Sekretariati duhet të vërtetojë në të gjitha kopjet e vendimit se vendimi i arbitrazhit është marrë në bazë të këtyre Rregullave.
6. Sekretariati duhet të dërgojë një kopje të vendimit tek secila palë. QAL do të mbajë një kopje të vendimit të arbitrazhit dhe vërtetimin e dorëzimit.

## Neni 42

### Afati kohor për vendimin përfundimtar

Vendimi përfundimtar duhet të bëhet jo më vonë se nëntë muaj nga data kur dosja i është përcjellur Tribunalit të Arbitrazhit në përputhje me Nenin 20. Për shkakë të arsyeshme, Bordi mund të zgjas këtë afat kohor me kërkesë të arsyetuar nga Tribunali i Arbitrazhit apo me iniciativë të saj. Duke bërë kështu, mund të kërkojë nga Tribunali i Arbitrazhit shpjegime mbi statusin e rastit dhe arsyet për pamundësinë e tij që të marr vendimin brenda afatit.

## Neni 43

### Marrëveshja dhe bazat e tjera për përfundimin e procedurës

1. Nëse para se të lëshohet vendimi i arbitrazhit palët arrijnë marrëveshje, Tribunali i Arbitrazhit duhet të lëshojë urdhër për ndërprerjen e procedurës ose, nëse ashtu kërkohet nga palët dhe pranohet nga Tribunali, të regjistrohet marrëveshja në formë të vendimit mbi kushtet e dakorduara. Dispozitat e Nenit 40 dhe 41 duhet të zbatohen ndaj një vendimi mbi kushtet e dakorduara por Tribunali i Arbitrazhit nuk është i detyruar të jap arsye për një vendim të tillë.
2. Nëse, para se të lëshohet vendimi përfundimtar, vazhdimi i procedurës bëhet i panevojshëm ose i pamundur për çfardo

arsye e cila nuk është e paraparë në paragrafin 1, Tribunali i Arbitrazhit do të njoftojë palët mbi qëllimin e tij që të lëshojë urdhërin mbi ndërprerjen e procedurës. Tribunali i Arbitrazhit mund të lëshojë një urdhër të tillë përveç nëse pala ngit bazë të arsyeshme për kundërshtim.

#### **Neni 44**

#### **Korrigjimi dhe interpretimi i vendimit të arbitrazhit dhe vendimit shtesë**

1. Brenda 30 ditë nga data e pranimit të vendimit, me njoftim për palët e tjera dhe Sekretariatën, pala mund të kërkojë nga Tribunali i Arbitrazhit:
  - i. korrigjim të çfardo gabimi tipografik, kompjuterik, apo tjetër të ngjashëm në vendimin e arbitrazhit;
  - ii. interpretim të ndonjë pike apo pjese specifike të vendimit të arbitrazhit;
  - iii. vendim shtesë lidhur me pretendimet e prezantuara përgjatë procedurës por të papercaktuara në vendimin përfundimtar.
2. Tribunali i Arbitrazhit do të ju jap palëve të tjera mundësinë që të paraqesin komente lidhur me kërkesën e referuar në paragrafin 1. Nëse Tribunali i Arbitrazhit e konsideron kërkesën e arsyeshme, ai duhet të bëjë korrigjimin ose të ofrojë interpretimin e vendimit të arbitrazhit brenda 30 ditë nga data e pranimit të kërkesës apo marrja e vendimit shtesë brenda 60 ditë nga data e pranimit të kërkesës. Për shkaqe të arsyeshme, Bordi mund të zgjasë afatet kohore sipas këtij paragrafi në bazë të kërkesës së arsyetuar të Tribunalit të Arbitrazhit.
3. Tribunali i Arbitrazhit poashtu mund të korrigjojë gabimet e referuara në paragrafin 1(i) me iniciativë të saj brenda 30 ditëve pas lëshimit të vendimit përfundimtar.
4. Dispozitat e Nenit 40 dhe 41 do të zbatohen për çfardo korrigjimi apo interpretimi të një vendimi të arbitrazhit dhe të çfardo vendimi shtesë. Korrigjimi apo interpretimi i vendimit përfundimtar është pjesë e vendimit përfundimtar.



# SHPENZIMET E PROCEDURËS SË ARBITRAZHIT

## Neni 45

### Shpenzimet e arbitrazhit

1. Shpenzimet e arbitrazhit përbëhen nga:
  - i. tarifat e Tribunalit të Arbitrazhit
  - ii. tarifa administrative e QAL; dhe
  - iii. shpenzimet e Tribunalit të Arbitrazhit dhe të QAL.
2. Para se të mirret vendimi përfundimtar, Tribunali i Arbitrazhit do të merr nga Sekretariati një përcaktim final të shpenzimeve të arbitrazhit. Sekretariati duhet të përcaktojë shpenzimet e arbitrazhit në përputhje me Tabelën e Shpenzimeve (Shtojca II), në fuqi në datën e fillimit të procedurës.
3. Kur procedura ka përfunduar përmes urdhërit për ndërprerje të procedurës apo një vendimi me kushtet të dakorduara, para lëshimit të vendimit përfundimtar, Sekretariati duhet përfundimisht të përcaktojë shpenzimet e arbitrazhit, duke pasur parasysh fazën në të cilën procedura ka përfunduar, punën e kryer nga Tribunali i Arbitrazhit dhe çfardo rrethane tjetër relevante. Në raste të tilla, tarifat e Tribunalit të Arbitrazhit mund të jenë më të ulëta se vlera minimale e cila rezulton nga Shtojca II.
4. Në vendimin përfundimtar, Tribunali i Arbitrazhit do të përfshijë vendimin mbi kushtet e dakorduara ose urdhërin për ndërprerjen e procedurës, shpenzimet e arbitrazhit siç janë përcaktuar përfundimisht nga Sekretariati dhe të specifikojë tarifat individuale dhe shpenzimet e secilit arbitër dhe QAL.
5. Përveç nëse palët janë pajtuar ndryshe, Tribunali i Arbitrazhit me kërkesë të njëres palë do të ndajë shpenzimet e arbitrazhit në mes të palëve duke pasur parasysh rezultatin e rastin dhe çfardo rrethane tjetër relevante.
6. Palët janë bashkarisht dhe veçmas përgjegjëse ndaj arbitërve dhe QAL për shpenzimet e arbitrazhit.
7. Tarifa e regjistrimit, tarifa administrative e QAL dhe tarifat e Tribunalit të Arbitrazhit të parashikuara në Shtojcën II nuk përfshinë tatimin mbi vlerën e shtuar. Pas emërimit të tyre, arbitrit duhet të informojnë Sekretariatit mbi shkallën e tatimit mbi vlerën e shtuar e cila do të ngarkohet në tarifën e tyre.

## Neni 46

### Shpenzimet e bëra nga palët

Përveç nëse palët janë pajtuar ndryshe, Tribunali i Arbitrazhit në vendimin përfundimtar, në vendimin mbi kushtet e dakorduara ose në urdhërin për ndërprerjen e procedurës, me kërkesë të një pale, duhet të vendos mbi rimbursimin e çfardo shpenzimi të arsyeshëm të bërë nga palët, përfshirë shpenzimet për përfaqësim ligjor. Duke bërë kështu, duhet të ketë parasysh rezultatet e rastit dhe çfardo rrethanë tjetër relevante.

## Neni 47

### Paradhënia e shpenzimeve të arbitrazhit

1. Sekretariati duhet të përcaktojë shumën për tu paguar nga palët si paradhënie e shpenzimeve të arbitrazhit.
2. Paradhënia duhet të korrespondojë me shumën e vlerësuar të shpenzimeve të arbitrazhit siç definohet me Nenin 45(1). Pagesa e paradhënies duhet të i bëhet QAL përmes transferit bankar.
3. Paditësi dhe i Padituri duhet të paguajnë gjysmën e paradhënies, përveç nëse janë përcaktuar paradhënie të ndara. Kur janë paraqitur kundërpadi dhe padi për kompensim të ndërsjelltë, Sekretariati mund të përcaktojë paradhënie të ndara për secilën prej palëve, duke korresponduar me pretendimin përkatës. Nëse paradhënia nuk mjafton që të mbulojë shpenzimet e arbitrazhit apo në raste të tjera të arsyetuara, Sekretariati me kërkesë të Tribunalit të Arbitrazhit apo me iniciativë të tij, mund të urdhërojë palët që të paguajnë një paradhënie shtesë.
4. Nëse pala dështon të paguaj paradhënien e kërkuar brenda afatit të përcaktuar nga Sekretariati, Sekretariati do të udhëzoj palën tjetër që të bëjë pagesën dhe të përcaktojë afatin e pagesës. Nëse pagesa nuk bëhet, Sekretariati mund të përfundojë procedurën në tërësi ose pjesërisht. Nëse pala tjetër bën pagesën, me kërkesë të asaj pale, Tribunali i Arbitrazhit mund të bëjë një vendim të ndarë me anë të së cilit urdhëron palën mos-paguese që të rimbursojë palën tjetër për paradhënien e paguar.
5. Pasi të përfundojë procedura, çfardo shume e papërdorur e paradhënies do ti kthehet palëve.

# PROCEDURA E PËRSHPEJTUAR E ARBITRAZHIT

## Neni 48

### Rregullat për Procedurën e Përsheptuar të Arbitrazhit

1. Rregullat për Procedurën e Përsheptuar të Arbitrazhit duhet të zbatohen kur palët shprehimisht janë pajtuar për procedurë të përsheptuar qoftë nëpërmjet marrëveshjes së arbitrazhit apo në një fazë të mëvonshme. Palët mund të pajtohen për procedurë të përsheptuar jo më vonë se me dorëzimin e Përgjigjes ndaj Kërkesës për Arbitrazh.
2. Kur palët janë pajtuar për procedurë të përsheptuar, do të zbatohen Rregullat e Arbitrazhit të Qendrës së Arbitrazhit të Lubjanës në Odën e Tregtisë dhe Industrisë së Sllovenisë me ndryshimet e përcaktuara në këtë Nen.
3. Përveç nëse palët janë pajtuar ndryshe, procedura e përsheptuar do të udhëhiqet nga një arbitër i vetëm, përveç atëherë kur Bordi përcakton se në bazë të kompleksitetit dhe rrethanave të tjera të rastit, procedura e përsheptuar duhet të udhëhiqet nga Tribunali i Arbitrazhit i përbërë nga tre arbitër.
4. Kur Tribunali i Arbitrazhit përbëhet nga një arbitër i vetëm, palët duhet të nominojnë bashkarisht arbitrin brenda 15 ditëve prej kur janë udhëzuar të bëjnë këtë nga Sekretariati. Nëse arbitri i vetëm nuk është nominuar brenda këtij afati, emërimi do të bëhet nga Bordi.
5. Kur Tribunali i Arbitrazhit përbëhet nga më shumë se një arbitër, Paditësi duhet të nominojë një arbitër nëpërmjet Kërkesës për Arbitrazh, përderisa i Padituri duhet të nominojë një arbitër brenda 15 ditë prej kur është udhëzuar të bëjë këtë nga Sekretariati. Brenda 15 ditë prej kur janë udhëzuar nga Sekretariati, arbitrit duhet të nominojnë arbitrin i cili do të veprojë si Kryesues i Tribunalit të Arbitrazhit. Kur arbitri nuk nominohet brenda këtij afati, emërimi duhet të bëhet nga Bordi.
6. Vendimi përfundimtar do të lëshohet jo më vonë se gjashtë muaj nga data në të cilën dosja i është përcjellur Tribunalit të Arbitrazhit në përputhje me Nenin 20. Për shkaqe të arsyeshme, Bordi mund të zgjas këtë afat me pranimin e një kërkesë të arsyetuar nga Tribunali i Arbitrazhit apo me iniciativë të tij. Duke bërë kështu, ai mund të kërkojë nga

Tribunali i Arbitrazhit sqarime lidhur me statusin e rastit dhe arsyet për pamundësinë e tij që të lëshojë vendimin brenda afatit.

7. Tribunali i Arbitrazhit do të udhëheq procedurën në atë mënyrë që të jetë i aftë të lëshoj vendimin përfundimtar brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 6. Përveç nëse Tribunali i Arbitrazhit përcakton ndryshe, do të zbatohen dispozitat në vijim:
  - i. pas dorëzimit të Përgjigjes në Kërkesën për Arbitrazh, si rregull, palët do të kenë të drejtë të paraqesin vetëm Padinë, Deklaratën e Mbrojtjes dhe çfardo kundërpadi apo padi për kompenzim të ndërsjelltë dhe përgjigjen në to;
  - ii. të gjitha njoftimet dhe komunikimet duhet të bëhen në mënyrë elektronike;
  - iii. si rregull, afatet e përcaktuara nga Tribunali i Arbitrazhit për paraqitjen e parashtrësive nuk do të jenë më të gjata se 15 ditë;
  - iv. përveç nëse palët janë pajtuar se mosmarrëveshja do të vendoset vetëm mbi bazë të parashtrësive, Tribunali i Arbitrazhit mund të mbajë një seancë dëgjimore;
  - v. pasi të jetë mbajtur seanca dëgjimore nuk mund të paraqiten parashtrësia të tjera; dhe
  - vi. Tribunali i Arbitrazhit duhet të theksojë përmbledhjen e arsyeve në të cilat bazohet vendimi, përveç nëse palët janë pajtuar se arsyet nuk duhet të jepen.

# RREGULLAT E PËRGJITHSHME

## Neni 49

### Rregullat e përgjithshme

Për të gjitha çështjet e parregulluara në këto Rregulla, Tribunali i Arbitrazhit, palët dhe QAL do të veprojnë në frymë të këtyre Rregullave dhe me qëllim të sigurimit të zbatueshmërisë së vendimit.

## Neni 50

### Konfidencialiteti

1. Përveç nëse palët shprehimisht janë pajtuar ndryshe, QAL, arbitrit dhe arbitri urgjent duhet të mbajnë konfidenciale procedurën, vendimin e arbitrazhit, urdhërat, dhe vendimet e tjera të Tribunalit të Arbitrazhit. Obligimi është poashtu i vlefshëm ndaj çfardo eksperti të emëruar nga Tribunali i Arbitrazhit si dhe anëtarëve të Bordit dhe Sekretariatit.
2. Përveç nëse palët shprehimisht janë pajtuar ndryshe, ato marrin përsipër që të mbajnë konfidenciale të gjitha vendimet, urdhërat, dhe vendimet e tjera të Tribunalit të Arbitrazhit dhe të gjitha dokumentet e paraqitura në procedurë nga një palë, të cilat nuk janë në dispozicion të publikut, përveç kur dhe në atë masë që shpalosja kërkohet nga një palë si detyrim ligjor apo për të mbrojtur ose ndjekur të drejta ligjore ose të zbatojë apo sfidojë një vendim para autoritetit gjyqësor.
3. Diskutimet e Tribunalit të Arbitrazhit janë konfidenciale.
4. QAL mund të bëjë publikimin e vendimit të arbitrazhit, urdhërave apo vendimeve të tjera të Tribunalit të Arbitrazhit në formë anonime dhe e cila nuk mundëson identifikimin e palëve ose personave të tjerë përveç nëse pala kundërshton me shkrim këtë publikim brenda 60 ditë nga dita e lëshimit të vendimit.

## Neni 51

### Verzioni gjuhësor i Rregullave

Ku gjuha e procedurës nuk është gjuha Sllovene, versioni i gjuhës Angleze i këtyre Rregullave do të mbizotërojë mbi verzionet e tjera gjuhësore.

## **Neni 52**

### **Përrjashtimi i përgjegjësisë**

Arbirit, arbitrit urgjent, QAL, anëtarët e Bordit dhe të Sekretariatit, Oda e Tregtisë dhe Industrisë së Sllovenisë dhe nënpunësit e saj nuk do të mbahen përgjegjës për asnjë veprim ose mangësi në lidhje me procedurën me kusht që ky përrjashtim i përgjegjësisë është i lejueshëm në bazë të ligjit të zbatueshëm.

## **Neni 53**

### **Hyrja në fuqi**

Këto Rregulla hyjnë në fuqi me 1 janar 2014.

SHTOJCAT





# SHTOJCË I

## ORGANIZIMI I QAL

### Neni 1

#### QAL

1. Qendra e Arbitrazhit e Lubjanës në Odën e Tregtisë dhe Industrisë së Sllovenisë (QAL) është institucion i pavarur dhe autonom i cili ofron shërbime administrative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.
2. QAL përbëhet nga Bordi dhe Sekretariati. Kushtet për funksionimin e QAL përcaktohen nga Oda e Tregtisë dhe Industrisë së Sllovenisë.

### Neni 2

#### Funksionet e QAL

QAL:

- i. administron zgjidhjen e mosmarrëveshjeve vendore dhe ndërkombëtare me arbitrazh, pajtim, dhe forma të tjera të zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve në përputhje me rregullat e saj dhe rregulla dhe procedura të tjera të dakorduara nga palët; dhe
- ii. ofron informata lidhur me arbitrazhin, pajtimin, dhe format e tjera të zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve.

### Neni 3

#### Bordi

1. Bordi përbëhet nga Kryesuesi, Zëvendës Kryesuesi dhe pesë anëtarë.
2. Brenda fushëveprimit të procedurave individuale, Bordi duhet të aprovojë vendimet brenda kompetencës së tij në përputhje me këto Rregulla apo rregulla të tjera të QAL të dakorduara nga palët. Vendimet e Bordit janë përfundimtare dhe nuk kërkohet të jenë të përcjellura me arsyetim.
3. Takimet e Bordit do të mbahen dhe udhëheqen nga Kryesuesi ose, në mungesë të pranisë së tij apo saj, nga Zëvendës Kryesuesi. Kuorumi përbëhet nga tre anëtarë të Bordit. Bordi do të aprovojë vendimet me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm. Nëse nuk mund të arrihet shumica, Kryesuesi

do të ketë votën vendimtare. Një anëtar i Bordit nuk mund të abstenoj nga votimi.

4. Në raste urgjente, Kryesuesi apo në mungesë të tij apo saj Zëvendës Kryesuesi, mund të aprovojnë vendime në emër të Bordit.
5. Një anëtar i Bordit nuk do të ketë të drejtë vote nëse vota ka të bëjë me procedurën në të cilën ai ose ajo është emëruar si arbitër. Ky fakt nuk do të ndikojë në kuorumin e nevojshëm të Bordit.

#### **Neni 4**

##### **Emërimi i Bordit**

1. Bordi do të emërohet nga Bordi i Drejtorëve i Odës së Tregtisë dhe Industrisë së Sllovenisë (Bordi i Drejtorëve).
2. Mandati i Kryesuesit, Zëvendës Kryesuesit dhe anëtarëve të Bordit do të jetë katër vite me mundësi të riemërimit.
3. Në rrethana të jashtëzakonshme, Bordi i Drejtorëve mund të pushojë nga detyra një anëtar Bordi. Nëse mandati i anëtarit të Bordit përfundon për shkak të dorëheqjes, pushimit nga detyra, apo ndonjë arsye tjetër, Bordi i Drejtorëve duhet të emëroj një anëtarë të ri të Bordit për pjesën e mbetur të mandatit.

#### **Neni 5**

##### **Sekretariati**

1. Sekretariati mbikqyrë efikasitetin e procedurës dhe punën e arbitërve si dhe kryen detyra të tjera në përputhje me këto Rregulla. Sekretariati menaxhohet nga Sekretari Gjeneral.
2. Brenda fushëveprimit të procedurave individuale, Sekretariati duhet të miratoj vendimet brenda kompetencës së saj në përputhje me këto Rregulla ose rregulla të tjera të QAL të dakorduara nga palët. Vendimet e Sekretariatit janë përfundimtare dhe nuk kërkohet të jenë të përcjellura me arsyetim.
3. Sekretariati mund të marr vendime që janë në kompetencë të Bordit, dhe të cilat i janë transferuar Sekretariatit nga Bordi.

## Neni 6

### **Emërimi i Sekretarit Gjeneral**

Sekretari Gjeneral do të emërohet nga Presidenti i Odës së Tregtisë dhe Indistrisë së Sllovenisë me pajtimin e Kryesuesin e Bordit për mandat katër vjeçar me mundësi të riemërimit.

## Neni 7

### **Puna e QAL**

QAL do të mbajë konfidencialitetin e procedurës, vendimeve, urdhërave dhe vendimeve të tjera. Në të gjitha procedurat, QAL do të jetë e paanshme dhe të veprojë në mënyrë të shpejtë.

# SHTOJCË II

## TABELA E SHPENZIMEVE

### Neni 1

#### Tarifa e regjistrimit

1. Tarifa e regjistrimit e referuar në Nenin 6 të Rregullave ka vlerën prej EUR 1,000 dhe është e pakthyeshme.
2. Tarifa e regjistrimit është pjesë e tarifës administrative të QAL e referuar në Nenin 3 të kësaj Shtojce.
3. Tarifa e regjistrimit do të shtohet në paradhënien e cila paguhet nga Paditësi në përputhje me Nenin 47 të këtyre Rregulave.

### Neni 2

#### Tarifat e Tribunalit të Arbitrazhit

1. Sekretariati do të përcaktojë tarifën e Kryesuesit të Tribunalit të Arbitrazhit dhe të arbitrit të vetëm në bazë të Tabelës A. Tarifa e arbitrit të vetëm do të jetë 20 përqind më e lartë se tarifa e Kryesuesit të Tribunalit të Arbitrazhit.
2. Secili bashkëarbitër do të pranojë 60 përqind të tarifës së Kryesuesit të Tribunalit të Arbitrazhit. Pas konsultimit paraprak me Tribunalin e Arbitrazhit, Sekretariati mund të përcaktojë se do të zbatohet një përqindje tjetër.
3. Si vlerë e mosmarrëveshjes do të përcaktohet vlera totale e të gjitha padive dhe kundërpadive. E njëjta aplikohet për padi për kompensim të ndërsjelltë përveç nëse shqyrtimi i tyre nuk paraqet rritje të konsiderueshme të punës. Kur nuk mund të përcaktohet vlera e mormarrëveshjes, Sekretariati do të përcaktojë tarifën e Tribunalit të Arbitrazhit duke marrë parasysh të gjitha rrethanat relevante të rastit.
4. Në përcaktimin e tarifave të Tribunalit të Arbitrazhit, Sekretariati do të marrë parasysh kujdesin dhe efikasitetin e arbitërve, sasinë e punës së kryer, kompleksitetin e rastit, efikasitetin e procedurës dhe afatin e lëshimit të vendimit. Në raste të jashtëzakonshme, Sekretariati mund të devijojë nga vlerat e përcaktuara në Tabelën A.

### Neni 3

#### Tarifa Administrative e QAL

1. Sekretariati do të përcaktojë tarifat administrative të QAL në bazë të Tabelës B.
2. Si vlerë e mosmarrëveshjes do të përcaktohet vlera totale e të gjitha padive dhe kundërpadive. E njejta aplikohet për padi për kompensim të ndërsjelltë përveç nëse shqyrtimi i tyre nuk paraqet rritje të konsiderueshme të punës. Kur nuk mund të përcaktohet vlera e mormarrëveshjes, Sekretariati do të përcaktojë tarifën e Tribunalit të Arbitrazhit duke marrë parasysh të gjitha rrethanat relevante të rastit.
3. Në rrethana të jashtëzakonshme, Sekretariati mund të devijojë nga vlerat e përcaktuara në Tabelën B.

### Neni 4

#### Shpenzimet e Tribunalit të Arbitrazhit dhe të QAL

1. Përveç tarifave të Tribunalit të Arbitrazhit dhe të tarifave administrative të QAL, Sekretariati do të përcaktojë një vlerë e cila do të mbulojë çfardo shpenzimi të arsyeshëm të bërë nga arbitrit dhe QAL.
2. Shpenzimet e Tribunalit të Arbitrazhit poashtu mund të përfshijnë tarifat dhe shpenzimet e ekspertëve të emëruar nga Tribunali i Arbitrazhit në përputhje me Nenin 34 të Rregullave.
3. QAL mund të lëshoj udhëzime për kalkulimin e shpenzimeve të Tribunalit të Arbitrazhit.

TABELA A

Vlera e mosmarrëveshjes			Tarifa e Kryesuesit të Tribunalit të Arbitrazhit <sup>1</sup>		
(në EUR)	Minimumi (në EUR)	Maksimumi (në EUR)			
deri në 25,000	1,800	2,700			
nga 25,000 deri në 50,000	1,800 + 2.8 % e vlerës më lartë 25,000	2,700 + 4.2 % e vlerës më lartë 25,000			
nga 50,000 deri në 100,000	2,500 + 4.2 % e vlerës më lartë 50,000	3,750 + 6.3 % e vlerës më lartë 50,000			
nga 100,000 deri në 250,000	4,600 + 1.6 % e vlerës më lartë 100,000	6,900 + 2.4 % e vlerës më lartë 100,000			
nga 250,000 deri në 500,000	7,000 + 1.56 % e vlerës më lartë 250,000	10,500 + 2.34 % e vlerës më lartë 250,000			
nga 500,000 deri në 1,000,000	10,900 + 1.22 % e vlerës më lartë 500,000	16,350 + 1.83 % e vlerës më lartë 500,000			
nga 1,000,000 deri në 2,000,000	17,000 + 0.64 % e vlerës më lartë 1,000,000	25,500 + 0.96 % e vlerës më lartë 1,000,000			
nga 2,000,000 deri në 5,000,000	23,400 + 0.42 % e vlerës më lartë 2,000,000	35,100 + 0.63 % e vlerës më lartë 2,000,000			
nga 5,000,000 deri në 10,000,000	36,000 + 0.34 % e vlerës më lartë 5,000,000	54,000 + 0.51 % e vlerës më lartë 5,000,000			
nga 10,000,000 deri në 20,000,000	53,000 + 0.2 % e vlerës më lartë 10,000,000	79,500 + 0.3 % e vlerës më lartë 10,000,000			
nga 20,000,000 deri në 50,000,000	73,000 + 0.12 % e vlerës më lartë 20,000,000	109,500 + 0.18 % e vlerës më lartë 20,000,000			
nga 50,000,001	<b>të përcaktohet nga Bordi</b>				

<sup>1</sup> Tarifa e arbitrit të vetëm është 20 % më e lartë se tarifa e Kryesuesit të Tribunalit të Arbitrazhit.

**TABELA B**

Vlera e mosmarrëveshjes (në EUR)	Tarifa administrative e QAL (në EUR)
deri në 25,000	2,000
nga 25,000 deri në 50,000	2,000 + 2 % e vlerës më lartë 25,000
nga 50,000 deri në 100,000	2,500 + 2 % e vlerës më lartë 50,000
nga 100,000 deri në 250,000	3,500 + 1 % e vlerës më lartë 100,000
nga 250,000 deri në 500,000	5,000 + 1 % e vlerës më lartë 250,000
nga 500,000 deri në 1,000,000	7,500 + 0.4 % e vlerës më lartë 500,000
nga 1,000,000 deri në 2,000,000	9,500 + 0.31 % e vlerës më lartë 1,000,000
nga 2,000,000 deri në 5,000,000	12,600 + 0.08 % e vlerës më lartë 2,000,000
nga 5,000,000 deri në 10,000,000	15,000 + 0.06 % e vlerës më lartë 5,000,000
nga 10,000,000 deri në 20,000,000	18,000 + 0.02 % e vlerës më lartë 10,000,000
nga 20,000,000 to 50,000,000	20,000 + 0.005 % e vlerës më lartë 20,000,000
nga 50,000,001	21,500

# SHTOJCË III

## PROCEDURA E ARBITRIT URGJENT

### Neni 1

#### Arbitri Urgjent

1. Procedura e Arbitrit Urgjent do të fillojë me aplikimin e palës në përputhje me Nenin 38 të Rregullave.
2. Një arbitër urgjent do të ketë kompetencat e referuara në Nenin 37 (1) dhe (2) të Rregullave.
3. Kompetencat e Arbitrit Urgjent do të përfundojnë kur dosja i është përcjellur Tribunalit të Arbitrazhit në përputhje me Nenin 20 të Rregullave ose kur masa e përkohshme pushon të jetë detyruese për palët në përputhje me Nenin 7(3) të kësaj Shtojce.
4. Kur dosja i është përcjellur një Tribunali të Arbitrazhit para se Arbitri Urgjent të ketë dhënë urdhërin për masë të përkohshme, Arbitri Urgjent do të mbajë kompetencën që të urdhëroj masë të përkohshme brenda afatit të referuar në Nenin 6(2) të kësaj Shtojce.

### Neni 2

#### Zbatimi i Procedurës së Arbitrit Urgjent

1. Si rregull një palë duhet të dërgojë Kërkesën për Procedurë të Arbitrit Urgjent (Kërkesa) tek QAL nëpërmjet postës elektronike.
2. Kërkesa duhet të përfshijë:
  - i. emrat, adresat dhe detajet e kontaktit (adresa e email, numri i telefonit dhe faksit) të palëve dhe përfaqësuesve të tyre;
  - ii. një kopje të marrëveshjes së arbitrazhit apo, në mungesë të një dokumenti i cili përmbanë marrëveshjen e arbitrazhit, në përshkrim dhe çfardo dëshmie të ekzistencës së një marrëveshje për të arbitruar;
  - iii. përshkrimi i mosmarrëveshjes;
  - iv. një deklaratë të masës (masave) të përkohshme të cilat kërkohen dhe arsyet për këtë;



- v. arsyet për urgjencën, për shkak të të cilave urdhërimi i një mase të përkohshme nuk mund të pres themelimin e Tribunalit të Arbitrazhit;
  - vi. një propozim lidhur me gjuhën dhe vendin e Procedurës së Arbitrit Urgjent si dhe lidhur me ligjin e zbatueshëm; dhe
  - vii. dëshminë e pagesës së shpenzimeve të Procedurës së Arbitrit Urgjent në përputhje me Nenin 8 të kësaj Shtojce.
3. Kërkesa duhet të paraqitet në gjuhën e procedurës së arbitrazhit siç janë pajtuar palët. Në mungesë të një marrëveshje të tillë, kërkesa duhet të paraqitet në gjuhën e marrëveshjes së arbitrazhit.
  4. Kur pala aplikon për Procedurë të Arbitrit Urgjent para paraqitjes së Kërkesës për Arbitrazh, pala duhet të paraqes Kërkesën për Arbitrazh brenda 10 ditë nga dita e pranimit të Kërkesës nga Sekretariati. Në të kundërtën, Sekretariati do të përfundojë Procedurën e Arbitrit Urgjent.
  5. Pas pranimit të Kërkesës, Sekretariati do të ja përcjell atë palës tjetër pa vonesë.

### Neni 3

#### Emërimi i Arbitrit Urgjent

1. Bordi do të emërojë Arbitrin Urgjent sa më shpejtë të jetë e mundur, por, si rregull, brenda 48 orë nga pranimi i Kërkesës. Pasi që të jetë bërë emërimi, Sekretariati do të ja transmetoj Kërkesën Arbitrit Urgjent pa vonesë.
2. Bordi nuk do të emëroj Arbitrin Urgjent atëherë kur është *prima facie* e qartë nga Kërkesa se nuk ka kompetencë mbi mosmarrëveshjen sipas këtyre Rregullave.
3. Arbitri Urgjent duhet të jetë i paanshëm dhe i pavarur. Ai apo ajo duhet të shpalojë çfardo rrethane e cila mund të ngris dyshime të arsyeshme lidhur me paanshmërinë dhe pavarësinë e tij apo saj. Neni 18 i Rregullave do të zbatohet për Arbitrin Urgjent, me përjashtim të afatit kohor të referuar në Nenin 18(2) të Rregullave, i cili do të jetë tre ditë.
4. Përveç nëse palët janë dakorduar ndryshe, Arbitri Urgjent nuk mund të emërohet si arbitër në asnjë procedure të lidhur me mosmarrëveshjen në të cilën ai apo ajo kanë vepruar si Arbitër Urgjent.

## Neni 4

### Vendi i Procedurës së Arbitrit Urgjent

Vendi i Procedurës së Arbitrit Urgjent do të jetë ai i cili është dakorduar nga palët si vend i arbitrazhit. Kur vendi i arbitrazhit nuk është përcaktuar nga palët, vendi do të jetë Lubjana përveç nëse Bordi përcakton ndryshe duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e rastit.

## Neni 5

### Udhëheqja e Procedurës së Arbitrit Urgjent

Arbitri Urgjent do të udhëheqë Procedurën e Arbitrit Urgjent në atë mënyrë siç ai apo ajo e konsideron të përshtatshme, duke marrë marasysh rrethanat e rastit dhe natyrën urgjente të procedurës. Në cilindo rast, Arbitri Urgjent do të trajtojë palët në mënyrë të barabartë dhe secilës palë ti jep mundësi të arsyeshme për të prezantuar rastin.

## Neni 6

### Vendimet mbi masat e përkohshme

1. Arbitri Urgjent do të merr çdo vendim për masa të përkohshme në formë të urdhërit.
2. Urdhëri do të lëshohet jo më vonë se 15 ditë nga data në të cilën Kërkesa i është përcjellur Arbitrit Urgjent nga Sekretariati në përputhje me Nenin 3(1) të kësaj Shtojce. Për shkaqe të arsyeshme, Bordi mund të zgjas këtë afat kohor me kërkesën e Arbitrit Urgjent apo me iniciativë të vet. Duke bërë kështu, ai mund të kërkojë nga Arbitri Urgjent sqarime lidhur me statusin e rastit dhe arsyet për pamundësinë e tij apo saj që të lëshojë urdhërin brenda afatit.
3. Urdhëri duhet të:
  - i. bëhet me shkrim;
  - ii. të shënoj datën kur është marrë vendimi, vendin e Procedurës së Arbitrit Urgjent dhe arsyet në të cilat është bazuar; dhe
  - iii. të nënshkruhet nga Arbitri Urgjent.
4. Arbitri Urgjent duhet që menjëherë të dërgojë një kopje të urdhërit te palët dhe QAL.

## Neni 7

### Efekti i masës së përkohshme

1. Një masë e përkohshme do të jetë detyruese për palët. Duke u pajtuar për arbitrazh sipas këtyre Rregullave, palët pajtohen që të përmbushin një masë të përkohshme pa vonesë apo brenda afatit të përcaktuar nga Arbitri Urgjent.
2. Arbitri Urgjent mund të modifikojë, pezullojë apo përfundojë një masë të përkohshme në bazë të një kërkesë të arsyetuar nga ndonjëra palë.
3. Masa e përkohshme pushon së qeni detyruese për palët:
  - i. nëse Procedurat e Arbitrit Urgjent përfundojnë në përputhje me Nenin 2(4) të kësaj Shtojce; ose
  - ii. nëse pranohet kundërshtimi i Arbitrit Urgjent; ose
  - iii. nëse Arbitri Urgjent ose Tribunali i Arbitrazhit vendosin kështu; ose
  - iv. me përfundimin e procedurës së arbitrazhit, përveç nëse Tribunali i Arbitrazhit vendos ndryshe.
4. Tribunali i Arbitrazhit nuk është i detyruar për asnjë urdhër të Arbitrit Urgjent dhe arsyet në të cilat ai është bazuar.

## Neni 8

### Shpenzimet e Procedurës së Arbitrit Urgjent

1. Me paraqitjen e Kërkesës, pala kërkuese duhet të paguaj shpenzimet e Procedurës së Arbitrit Urgjent.
2. Shpenzimet e Procedurës së Arbitrit Urgjent përbëhen nga:
  - i. tarifa e Arbitrit Urgjent në vlerë prej 10,000 EUR; dhe
  - ii. tarifa administrative e pakthyeshme në vlerën prej 3,000 EUR.
3. Shpenzimet e Procedurës së Arbitrit Urgjent nuk përfshijnë tatimin mbi vlerën e shtuar.
4. Me kërkesën e Arbitrit Urgjent apo Bordi me iniciativë të tij mund të vendosë të rris apo zvogëloj shpenzimet e Procedurës së Arbitrit Urgjent duke marrë parasysh rrethanat e rastit, punën e kryer nga Arbitri Urgjent dhe QAL, dhe çfardo rrethane tjetër relevante.

5. Nëse pala dështon të paguaj me kohë shpenzimet e Arbitrit Urgjent, Sekretariati nuk do të marr parasysh Kërkesën ose do të përfundojë Procedurën e Arbitrit Urgjent.
6. Me kërkesë të një pale, Tribunali i Arbitrazhit në vendimin e arbitrazhit do të alokojë në mes të palëve shpenzimet e Procedurës së Arbitrit Urgjent.

## **Neni 9**

### **Rregulla e përgjithshme**

Të gjitha çështjet e parregulluara në këtë Shtojcë, Arbitri Urgjent, Bordi dhe Sekretariati do të veprojnë në frymë të kësaj Shtojce dhe të Rregullave të Arbitrazhit të Qendrës së Arbitrazhit në Odën e Tregtisë dhe Industrisë së Sllovenisë.

## SHTOJCË IV

# Tabela e Shpenzimeve për procedurën e përshpejtuar të arbitrazhit sipas Nenit 48 të Rregullave të Arbitrazhit të Qendrës së Arbitrazhit të Lubjanës në Odën e Tregtisë dhe Industrisë së Sllovenisë

### Neni 1

#### Tarifa e regjistrimit

1. Tarifa e regjistrimit e referuar në Nenin 6 të Rregullave ka vlerën prej EUR 1,000 dhe është e pakthyeshme.
2. Tarifa e regjistrimit është pjesë e tarifës administrative të QAL e referuar në Nenin 3 të kësaj Shtojce.
3. Tarifa e regjistrimit do të shtohet në paradhënien e cila paguhet nga Paditësi në përputhje me Nenin 47 të këtyre Rregulave.

### Neni 2

#### Tarifat e Tribunalit të Arbitrazhit

1. Sekretariati do të përcaktojë tarifën e Kryesuesit të Tribunalit të Arbitrazhit dhe të arbitrit të vetëm në bazë të Tabelës A. Tarifa e arbitrit të vetëm do të jetë 20 përqind më e lartë se tarifa e Kryesuesit të Tribunalit të Arbitrazhit.
2. Secili bashkëarbitër do të pranojë 60 përqind të tarifës së Kryesuesit të Tribunalit të Arbitrazhit. Pas konsultimit paraprak me Tribunalin e Arbitrazhit, Sekretariati mund të përcaktojë se do të zbatohet një përqindje tjetër.
3. Si vlerë e mosmarrëveshjes do të përcaktohet vlera totale e të gjitha padive dhe kundërpadive. E njëjta aplikohet për padi për kompenzim të ndërsjelltë përveç nëse shqyrtimi i tyre nuk paraqet rritje të konsiderueshme të punës. Kur nuk mund të përcaktohet vlera e mormarrëveshjes, Sekretariati do të përcaktojë tarifën e Tribunalit të Arbitrazhit duke marrë parasysh të gjitha rrethanat relevante të rastit.

4. Në përcaktimin e tarifave të Tribunalit të Arbitrazhit, Sekretariati do të marr parasysh kujdesin dhe efikasitetin e arbitërve, sasinë e punës së kryer, kompleksitetin e rastit, efikasitetin e procedurës dhe afatin e lëshimit të vendimit. Në raste të jashtëzakonshme, Sekretariati mund të devijojë nga vlerat e përcaktuara në Tabelën A.

### Neni 3

#### **Tarifa Administrative e QAL**

1. Sekretariati do të përcaktojë tarifën administrative të QAL në bazë të Tabelës B.
2. Si vlerë e mosmarrëveshjes do të përcaktohet vlera totale e të gjitha padive dhe kundërpasive. E njëjta aplikohet për padi për kompensim të ndërsjelltë përveç nëse shqyrtimi i tyre nuk paraqet rritje të konsiderueshme të punës. Kur nuk mund të përcaktohet vlera e mosmarrëveshjes, Sekretariati do të përcaktojë tarifën e Tribunalit të Arbitrazhit duke marrë parasysh të gjitha rrethanat relevante të rastit.
3. Në rrethana të jashtëzakonshme, Sekretariati mund të devijojë nga vlerat e përcaktuara në Tabelën B.

### Neni 4

#### **Shpenzimet e Tribunalit të Arbitrazhit dhe të QAL**

1. Përveç tarifave të Tribunalit të Arbitrazhit dhe të tarifave administrative të QAL, Sekretariati do të përcaktojë një vlerë e cila do të mbulojë çfardo shpenzimi të arsyeshëm të bërë nga arbitrit dhe QAL.
2. Shpenzimet e Tribunalit të Arbitrazhit poashtu mund të përfshijnë tarifën dhe shpenzimet e ekspertëve të emëruar nga Tribunali i Arbitrazhit në përputhje me Nenin 34 të Rregullave.
3. QAL mund të lëshoj udhëzime për kalkulimin e shpenzimeve të Tribunalit të Arbitrazhit.

### Neni 5

#### **Hyrja në fuqi**

Kjo Shtojcë hyn në fuqi me 1 mars 2019 dhe zbatohet në të gjitha procedurat e përshpejtuara të arbitrazhit sipas Nenit 48 të Rregullave të cilat kanë filluar pas datës 28 shkurt 2019.

**TABELA A**

Vlera e mosmarrëveshjes			Tarifa e Kryesuesit të Tribunalit të Arbitrazhit <sup>1</sup>	
(në EUR)	Minimumi (në EUR)		Minimumi (në EUR)	Maksimumi (në EUR)
deri në 25,000	720		1,080	
nga 25,000 deri në 50,000	720 + 1.4 % e vlerës më lartë 25,000		1,080 + 2.1 % e vlerës më lartë 25,000	
nga 50,000 deri në 100,000	1,000 + 2.1 % e vlerës më lartë 50,000		1,500 + 3.15 % e vlerës më lartë 50,000	
nga 100,000 deri në 250,000	1,840 + 1.6 % e vlerës më lartë 100,000		2,760 + 2.4 % e vlerës më lartë 100,000	
nga 250,000 deri në 500,000	7,000 + 1.56 % e vlerës më lartë 250,000		10,500 + 2.34 % e vlerës më lartë 250,000	
nga 500,000 deri në 1,000,000	10,900 + 1.22 % e vlerës më lartë 500,000		16,350 + 1.83 % e vlerës më lartë 500,000	
nga 1,000,000 deri në 2,000,000	17,000 + 0.64 % e vlerës më lartë 1,000,000		25,500 + 0.96 % e vlerës më lartë 1,000,000	
nga 2,000,000 deri në 5,000,000	23,400 + 0.42 % e vlerës më lartë 2,000,000		35,100 + 0.63 % e vlerës më lartë 2,000,000	
nga 5,000,000 deri në 10,000,000	36,000 + 0.34 % e vlerës më lartë 5,000,000		54,000 + 0.51 % e vlerës më lartë 5,000,000	
nga 10,000,000 deri në 20,000,000	53,000 + 0.2 % e vlerës më lartë 10,000,000		79,500 + 0.3 % e vlerës më lartë 10,000,000	
nga 20,000,000 deri në 50,000,000	73,000 + 0.12 % e vlerës më lartë 20,000,000		109,500 + 0.18 % e vlerës më lartë 20,000,000	
nga 50,000,001	<b>të përcaktohet nga Bordi</b>			

<sup>1</sup> Tarifa e arbitrit të vetëm është 20 % më e lartë se tarifa e Kryesuesit të Tribunalit të Arbitrazhit.

TABELA B

Vlera e mosmarrëveshjes (në EUR)	Tarifa administrative e QAL (në EUR)
deri në 25,000	1,000
nga 25,000 deri në 50,000	1,000 + 2 % e vlerës më lartë 25,000
nga 50,000 deri në 100,000	1,500 + 2 % e vlerës më lartë 50,000
nga 100,000 deri në 250,000	2,500 + 1 % e vlerës më lartë 100,000
nga 250,000 deri në 500,000	5,000 + 1 % e vlerës më lartë 250,000
nga 500,000 deri në 1,000,000	7,500 + 0.4 % e vlerës më lartë 500,000
nga 1,000,000 deri në 2,000,000	9,500 + 0.31 % e vlerës më lartë 1,000,000
nga 2,000,000 deri në 5,000,000	12,600 + 0.08 % e vlerës më lartë 2,000,000
nga 5,000,000 deri në 10,000,000	15,000 + 0.06 % e vlerës më lartë 5,000,000
nga 10,000,000 deri në 20,000,000	18,000 + 0.02 % e vlerës më lartë 10,000,000
nga 20,000,000 to 50,000,000	20,000 + 0.005 % e vlerës më lartë 20,000,000
nga 50,000,001	21,500



# KLAUZOLAT STANDARDE TË ARBITRAZHIT



# Arbitrazhi

Çfardo mosmarrëveshje, kontradikte, apo pretendimi që del nga apo në lidhje me këtë kontratë, përfshirë shkeljen, ndërprerjen ose vlerfshmërinë e saj, do të zgjidhet përfundimisht me arbitrazh në përputhje me Rregullat e Arbitrazhit të Qendrës së Arbitrazhit në Odën e Tregtisë dhe Industrisë së Sllovenisë.

*Shtesat e rekomanduara:*

- *Tribunali i arbitrazhit do të përbëhet nga [tre arbitër/ një arbitër i vetëm].*
- *Vendi i arbitrazhit do të jetë [qyteti dhe shteti].*
- *Gjuha e cila do të përdoret në procedurë të arbitrazhit do të jetë [...].*
- *Ligji i cili rregullon kontratën do të jetë ligji material i [...].*

## Arbitrazhi i Përshpejtuar

Çfardo mosmarrëveshje, kontradikte, apo pretendimi që del nga apo në lidhje me këtë kontratë, përfshirë shkeljen, ndërprerjen ose vlerfshëmërinë e saj, do të zgjidhet përfundimisht me arbitrazh në përputhje me Rregullat e Arbitrazhit të Qendrës së Arbitrazhit në Odën e Tregtisë dhe Industrisë së Sllovenisë me zbatimin e Rregullave për Procedurën e Përshpejtuar të Arbitrazhit.

*Shtesat e rekomanduara:*

- *Tribunali i arbitrazhit do të përbëhet nga [tre arbitër/ një arbitër i vetëm].*
- *Vendi i arbitrazhit do të jetë [qyteti dhe shteti].*
- *Gjuha e cila do të përdoret në procedurë të arbitrazhit do të jetë [...].*
- *Ligji i cili rregullon kontratën do të jetë ligji material i [...].*

## Arbitrazhi pa Arbitër Urgjent

Çfardo mosmarrëveshje, kontradikte, apo pretendimi që del nga apo në lidhje me këtë kontratë, përfshirë shkeljen, ndërprerjen ose vlerfshmërinë e saj, do të zgjidhet përfundimisht me arbitrazh në përputhje me Rregullat e Arbitrazhit të Qendrës së Arbitrazhit në Odën e Tregtisë dhe Industrisë së Sllovenisë. Dispozitat e Procedurës së Arbitrit Urgjent nuk do të zbatohen.

*Shtesat e rekomanduara:*

- *Tribunali i arbitrazhit do të përbëhet nga [tre arbitër/ një arbitër i vetëm].*
- *Vendi i arbitrazhit do të jetë [qyteti dhe shteti].*
- *Gjuha e cila do të përdoret në procedurë të arbitrazhit do të jetë [...].*
- *Ligji i cili rregullon kontratën do të jetë ligji material i [...].*

## Si të përdorni klauzolat standarde të arbitrazhit të QAL

Kur palët dëshirojnë të referojnë mosmarrëveshjet e tyre pranë Qendrës së Arbitrazhit të Lubjanës në Odën e Tregtisë dhe Industrisë së Sllovenisë (QAL), rekomandohet që ato të përfshijnë në kontratën e tyre njërën nga klauzolat standarde të arbitrazhit të paraqitura më lartë.

Duke përfshirë një klauzolë standarde të arbitrazhit në kontratën e tyre palët pajtohen që mosmarrëveshja e tyre të zgjidhet me arbitrazh në Qendrën e Arbitrazhit të Lubjanës në Odën e Tregtisë dhe Industrisë së Sllovenisë, duke siguruar kështu një zgjidhje të shpejtë, efikase, dhe profesionale të mosmarrëveshjes. Klauzolat standarde të arbitrazhit mund të ndryshohen ose përshtaten nga palët në përputhje me nevojat dhe rrethanat e tyre. Për shembull, palët mund të pajtohen për një numër tjetër të arbitërve (Rregullat e Arbitrazhit të Lubjanës përmbajnë prezumimin i cili favorizon tribunalin e arbitrazhit prej tre arbitërve). Palët poashtu mund të pajtohen për vendin e arbitrazhit, gjuhën e procedurës dhe ligjin e aplikueshëm për materien e mosmarrëveshjes.

Kur mosmarrëveshja është më pak e komplikuar apo vlera e mosmarrëveshjes është e ulët dhe zgjidhja e shpejtë është në veçanti me rëndësi për palët, ato mund të përfshijnë në kontratën e tyre klauzolën standarde të arbitrazhit e cila ofron zbatimin e Rregullave për Procedurën e Përshpejtuar të Arbitrazhit (Neni 48 i Rregullave të Arbitrazhit të Lubjanës).

Rregullat e Arbitrazhit të Lubjanës poashtu përfshijnë Procedurën e Arbitrit Urgjent (Shtojcë III). Kur palët dëshirojnë të tërhiqen nga Procedura e Arbitrit Urgjent, rekomandohet që ata të përfshijnë në kontratën e tyre klauzolën standarde të arbitrazhit për përjashtimin e dispozitave të Procedurës së Arbitrit Urgjent.

Kur të bëjnë hartimin e klauzolës së arbitrazhit palët duhet të bëjnë kujdes të veçantë. Është me rëndësi që klauzola e arbitrazhit të tregoj marrëveshje të qartë të palëve se çfarido mosmarrëveshje përfundimisht do të zgjidhet me arbitrazh (dhe jo gjykatë shtetërore) dhe se do të paraqitet për arbitrazh tek QAL. Një klauzolë e paqartë e arbitrazhit mund të pengojë në mënyrë të konsiderueshme apo edhe të rrezikojë procedurën e arbitrazhit.

Më shumë informata mbi procedurën e arbitrazhit dhe klauzolat standarde të arbitrazhit në gjuhët e tjera mund të gjinden në:

**[www.sloarbitration.eu](http://www.sloarbitration.eu)**